

Përshkrimi i kursit

Kontrolli i rrjedhjeve përbën një nga sfidat kryesore të shoqërive UK. Rrjedhjet janë një nga komponentet kryesor të ujit pa të ardhura. Ato shkaktojnë dëmtime në rrjetin shpërndarës të ujit dhe ndikojnë në cilësinë e tij për tek konsumatori. Prandaj, kontrolli dhe menaxhimi i duhur i tyre është i domosdoshëm.



Gjatë këtij kursi trajnimi pjesëmarrësit do të marrin njohuritë bazë të nevojshme mbi zhvillimin e strategjive të menaxhimit të rrjedhjeve dhe lokalizimin e tyre, si dhe të shpjegojnë teknikat e menaxhimit të presionit dhe mënyrën e projektimit të Zonave të Matura të Shërbimit (DMA).

Kush duhet të marrë pjesë

Ky kurs është hartuar për profesionistët e shoqërive ujësjellës kanalizime dhe është veçanërisht i vlefshëm për drejtorët e departamentit teknik dhe të shpërndarjes, kryeinxhinierët, inxhinierët e mirëmbajtjes dhe të shfrytëzimit, inxhinierët e matjes dhe inxhinierët projektues. Kursi është me interes dhe për inxhinierë konsulentë.

Objektivat e kursit të trajnimit

Në fund të këtij kursi trajnimi, ju do të jeni të aftë të:

- Identifikoni strategjitë bazë të kontrollit të rrjedhjeve;
- Përshkruani treguesit e performancës për rrjedhjet;

- Rendisni çështjet që duhet të merren parasysh gjatë zhvillimit të një plani për rrjedhjet;
- Identifikoni nivelin ekonomik të rrjedhjeve;
- Identifikoni disa prej teknikave të zbulimit të rrjedhjeve dhe teknologjitë e përdorura;
- Rendisni kriteret për përzgjedhjen e valvulave të reduktimit të presionit;
- Diskutoni mbi përzgjedhjen e matësve;
- Rendisni faktorët dhe komponentët që duhet të merren parasysh kur projektohet një DMA;
- Shpjegoni skemën tipike të një DMA-je;
- Diskutoni mbi menaxhimin e DMA-ve duke përfshirë mirëmbajtjen dhe monitorimin e tyre;
- Rendisni dhe të shpjegoni llojet e problemeve të DMA-ve.

Metoda e trajnimit

Trajnimi është i bazuar në leksione të prezantuara në Power Point, të ndërthurura me diskutime dhe raste studimore. Përveç marrjes së leksioneve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të analizojnë edhe raste konkrete studimore.

Materialet e kursit

Si pjesëmarrës në këtë kurs, ju do të pajiseni me Manualin e Trajnimit për Kontrollin e Rrjedhjeve. Përpos kësaj, ju do të pajiseni me çertifikatë e cila dëshmon pjesëmarrjen tuaj në këtë trajnim.

Tarifa e regjistrimit

Anëtarët e SHUKALB: 13,000 lekë për person
Jo-anëtarët: 16,000 lekë për person

Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe.

FORMULAR REGJISTRIMI

Emër Mbimër _____

Datëlindja _____

Institucioni _____

Pozicioni _____

Edukimi _____

Celular _____

E-mail _____

Adresa _____

Ju lutem, plotësoni këtë formular dhe dërgojeni në adresën e e-mailit training@shukalb.al.
Pagesën mund ta derdhni në llogarinë bankare të Shoqatës si më poshtë, duke specifikuar emrin tuaj dhe qëllimin e transfertës:

Banka: PROCREDIT, Dega Tiranë

Emri i Llogarisë: Shoqata e Ndërmarrjeve Ujësjiellës Kanalizime të Shqipërisë

Numri i Llogarisë: 10-831379-00-01

IBAN: AL 95209111080000108313790001

***Shënim:** Pjesëmarrja juaj në këtë aktivitet duhet të konfirmohet nëpërmjet e-mailit, telefonit apo postës.*

Nëse ju konfirmoni dhe mungoni në këtë trajnim pa paparalajmëruar minimalisht 3 ditë përpara, atëherë shuma e plotë e pagesës do tju mbahet.